




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Nr. 476/24
Data 30-05-24

Prishtinë, 13 maj 2024

Kodi i ZRRE-së: V_2013_2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,

Duke u bazuar në:

- Dispozitat e Nenit 9, paragrafi 1, nën paragrafi 1.7, Neni 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.5, Neni 25, Nenin 26 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 05/L-084);
- Dispozitat e Nenit 28, paragrafi 1.28 të Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085);
- Dispozitat e Nenit 10 të Ligjit për Energjinë (Ligji Nr. 05/L-081);
- Dispozitat e Nenit 10 të Licencës së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes;
- Dispozitat e Nenit 1, paragrafi 3 të Rregullës për Vlerësimin e Projekteve Kapitale në Rrjetin e Transmetimit dhe Shpërndarjes në Sektorin e Energjisë Elektrike;
- Dispozitat e Nenit 2, paragrafit 2 si dhe dispozitat e nenit 6 të Shtojcës 3 të Rregullës për të Hyrat e OSSH-së;
- Kërkesën e OSSH-së, të datës 27 tetor 2023 për shqyrtimin dhe aprovimin e Planit Investiv Një (1) për vitin 2024,

në seancën e mbajtur me datë 03 dhe 13 maj 2024 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** - Plani Investiv Një (1) Vjeçar i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) për vitin 2024.
- II. **OBLIGOHET** – Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, që të zbatojë projektet e planifikuara sipas këtij Plani për funksionimin më të sigurt të Sistemit të Shpërndarjes.

A r s y e t i m

- Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) me datë 27 tetor 2023 ka pranuar kërkesën e Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes për shqyrtim dhe aprovim të Planit Investiv Një (1) vjeçar për vitin 2024.
- ZRRE pas shqyrtimit fillestar të Planit Investiv një (1) vjeçar të Operatorit të Sistemit të



Shpërndarjes për vitin 2024, ka verifikuar harmonizimin e këtij plani me projektet investive të shqyrtuara dhe miratuara nga Rregullatori gjatë periudhës së tretë rregullative 2023-2027.

- Në këtë plan investiv për vitin 2024, ZRRE ka marrë parasysh vetëm kostot e tri projekteve shtesë që nuk ishin paraparë ne periudhën e tretë rregullative 2023-2027. Projektet shtesë janë: Revitalizimi i Linjës 35 kV, Rahovec- Malishevë; Projektet në njehsorë si rezultat i kërkesave ligjore; dhe Investimet në katër Komunat ne Veriun e Kosovës.
- Kapaciteti i kufizuar i infrastrukturës ekzistuese i linjës 35 kV Rahovec- Malishevë, ka rezultuar ne ndërprerje të furnizimit me energji, rënie të tensionit dhe në përgjithësi ne cilësi të dobët të shërbimit. Pas analizave të kujdesshme dhe për të eliminuar efektet negative te furnizimit te konsumatorëve ne Komunën e Malishevës, ZRRE-ja ka pranuar projektin për revitalizimin e Linjës 35 kV Rahovec – Malisheve si projekt shtesë për vitin 2024 ne vlerën prej 0.7mil€.
- Si rezultat i arritjes së marrëveshjes me Elektroserver për furnizimin e 4 komunave në Veriun e Kosovës është paraqitur nevoja për investime shtesë nga OSSH-ja, të cilat për shkak të rrethanave të panjohura nuk kanë mundur të shqyrtohen dhe vlerësohen në planin e aprovuar të investimeve për periudhën e tretë rregullative (2023-2027). Meqenëse marrëveshja është në fuqi nga 1 janari 2024, OSSH është në fazën e mbledhjes së të dhënave nga terreni mbi gjendjen ekzistuese, në bazë të cilës do të hartohet plani i detajuar për investimet e domosdoshme në 4 komunat e veriut të Kosovës. Kostot e parapara për instalimin e njehsorëve të njohura në këtë plan investiv për vitin 2024, përfshijnë vetëm njehsorët që do të instalohen në fazën e parë, 5000 njehsorë me kosto 0.2mil€, ndërsa kostot e parapara për fazën e dytë për njehsorët elektrik nuk janë përfshirë në këtë plan investiv për vitin 2024, pasi që nga diskutimet me akterët tjerë të përfshirë në këtë proces të njëjtat priten të financohen nga Bashkimi Evropian. Po ashtu, ne këtë plan investiv janë njohur kostot për stabilimente elektroenergetike të tensionit të mesëm dhe të ulët me kosto 0.75mil€ si dhe investimet urgjente ne infrastrukturë ne vlerën prej 2 mil€.
- Si rezultat i kërkesave ligjore, në planin investiv për vitin 2024, ZRRE, ka marrë parasysh kërkesën e OSSH-së për ndërrimin e njehsorëve sipas kërkesave të parapara në Rregullën për Zhvillimin e Profileve Karakteristike të Ngarkesave në Sistemin Energjetik, ndërrimin e njehsorëve si rezultat i skadimit të vlefshmërisë së bllombës, ndërrimin e njehsorëve mekanik me skadim të vlefshmërisë së bllombës para vitit 2020, si dhe shërbimet per zvogëlimin e humbjeve. Kostoja totale e vlerësuar në këtë plan investiv për sa i përket njehsorëve është rreth 2.2mil€.
- OSSH-ja, pas pranimit të këtij vendimi, duhet ta harmonizojë planin investiv një (1) një vjeçar, vetëm me projektet shtesë të njohura ta paraqitura në arsyetim të këtij vendimi. Planin Investiv një (1) vjeçar së bashku me këtë vendim, duhet të publikohet në faqen zyrtare të OSSH-së.
- Bordi i ZRRE, pas vlerësimit dhe analizimit të Planit Investiv Një (1) Vjeçar ka konstatuar që janë përmbushur kërkesat ligjore, dhe ka vlerësuar se projektet shtesë të përfshira janë të arsyeshme dhe të nevojshme për funksionimin e sigurt të sistemit të shpërndarjes, prandaj ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

III. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.



IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund t'i drejtohet Gjykatës Kompetente brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Ymer Fejzullahu, Kryesues

Lutfije Dervishi, anëtar

Gani Buçaj, anëtar

Arta Isufi, anëtar

Adnan Preniqi, anëtar

Vendimi dhe dokumenti i dërgohet:

- Të licencuarit – KEDS SH.A,
- Arkivit të ZRRE-së.